



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.690/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e kandidatit për deputet në Kuvendin e Kosovës nga rradhët e Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Bajram Kosumi, paraqitur kundër Komisionit Komunal zgjedhor në Kamenicë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 28.12.2010, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET** poshtë si e pasafatshme ankesa e kandidatit për deputet në Kuvendin e Kosovës, Bajram Kosumi nga rradhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

## A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 22.12.2010, nga Bajram Kosumi kandidat për deputet nga rradhët subjekti politik PDK, në të cilën pretendohet se në kutin e votimit 1001x/3R në shkollën teknike “Andrea Durrsaku” në Kamenicë, janë numëruar 58 vota për mua, ndërsa KKZ në Kamenicë i ka shënuar 0. Në secilën prej 4 kutive tjera të kësaj qendre të votimit kam nga rreth 50 vota (157 gjithsej), 58 votat e kutisë së pestë i janë bartur një kandidati tjetër, i cili në katër kutit tjera ka nga zero vota. Dëshmitarët thonë se mund të jenë gabim teknik.

Parashtruesi i ankesës ka përmendur si dëshmitar Arianit Musa Ahmeti, Jeton Maliqi, Gazmend Beqiri.

### *Neni 119 paragrafi 1 i LZP-së*

*Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqes një ankesë pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP-i do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetedy (72) orëve nga koha kur është parashtruar ankesa.*

PZAP gjeti se:

**-ankesa është e pasafatshme**

Sipas dispozitës së lartcekur PZAP-i konstaton se ankesa është e pasafatshme, sepse rasti ka të bëjë me ditën e zgjedhjeve më 12.12.2010 ndërsa ankesa në PZAP është pranuar me datën 24.12.2010, kurse afati për parashtrim të ankesës në PZAP, në këtë fazë të procedurës ka qenë njëzetekatër (24) orë.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
A nr. 690/2010 më datën 28.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Muhamet Rexha**

